


# DEMOKRACIA ËSHTË



# PËR TË GJITHË

# DEMOKRACIA JONË

ERDONESA (15), RAMIZ (15), MILOT (14), ALDIN (15), ARJANITA (16)



## Demokracia dhe roli ynë në të

Demokracia, sipas grupit tonë është forma më e mirë e udhëheqjes së shtetit. Pse mendojmë kështu? Është shumë e thjeshtë, sepse në demokraci jemi ne qytetarët ata që udhëheqim me votën tonë. Pra, roli ynë në demokraci është jashtëzakonisht i rëndësishëm. E ky fakt tregohet me anë të votës tonë.

Ne vijmë nga shkolla „Emin Duraku“ dhe jemi klasa IX-4. Klasa jonë e ka zgjedhur kryetaren e klasës, me anë të votave tona. Në këtë mënyrë, nëse klasën tonë e paramendojmë si një shtet, kurse mënyrën e zgjedhjes së kryetares si demokraci, ndërsa ne nxënësit si populli i atij shteti, atëherë ne kemi bërë një votim demokratik, njëjtë sikurse ndodh në shtetet demokratike. Përditshmëria jonë karakterizohet me paqe, tolerancë, solidaritet, barazi dhe respekt. Të gjitha këto i kemi falë demokracisë, sepse këto janë elementet kryesore të saj. Mirëpo, përveç këtyre elementeve, ne kemi edhe shumë të drejta, siç janë: e drejta për shkollim, për punësim, për shprehje të lirë, për votim etj.

Është shumë e rëndësishme që të jemi të gjithë të barabartë. Kur themi të barabartë, e kemi fjalën për të drejtat tona. Të drejtat nuk njohin gjini, fe, komb apo gjendje ekonomike. Pavarësisht të gjitha këtyre, të drejtat i kemi të barabarta.

Marrim shembull, klasën tonë ku të gjithë jemi të barabartë edhe pse jemi të ndryshëm. Megjithatë, barazia ka munguar ne demokracinë e vitit 507 para erës

sonë. Është fjala për kryeqytetin e Greqisë, Athinën, ku demokracia lindi për herë të parë, e cila ishte më ndryshe nga ajo që kemi ne sot. Kjo për shkak të pa-barazisë që ka ndodhur në atë kohë, ku të moshuarit, gratë, dhe të varfërit nuk kanë pasur të drejtë të votojnë.

Ekzistojnë dy lloje të demokracisë: demokracia përfaqësuese dhe ajo e drejtëpërdrejtë. Ne në Kosovë e kemi demokracinë përfaqësuese të sistemit parlamentar, sepse demokracia përfaqësuese ndahet në dy sisteme. Kjo do të thotë se në vendin tonë ne nuk e zgjedhim Presidentin drejtëpërdrejtë, por ne i zgjedhim deputetët, kurse ata e zgjedhin Presidentin.

Ndërkaq, në vendet që kanë sistem presidencial siç janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, populli e voton presidentin drejtëpërdrejtë.

Demokracia duhet të respektohet dhe ne ju ftojmë ta respektoni atë dhe të jeni sa më demokratik.



Autorët e artikullit



## ARDHMËRIA JONË

EDONIS (14), MUHAMED (14), KUSHTRIM (15), GENTIANA (14), KASTRIOT (14)

### Në këtë artikull mund të lexoni për demokracinë dhe llojet e zgjedhjeve

Zgjedhjet janë procesi ku populli zgjedh përfaqësuesit e vet. Zgjedhjet parlamentare janë kur populli zgjedh deputetët e tij, ndërsa ato presidenciale kur populli zgjedh Presidentin e shtetit.

Vota është e drejtë e njeriut, e cila ushtrohet mbi moshën 18 vjeçare, me anë të së cilës qytetarët zgjedhin atë që dëshirojnë apo që mendojnë se është më i miri që të udhëheqë vendin e tyre. Rëndësia e votës është shumë e madhe, për arsye se një votë mund ta ndryshoj ardhmërinë e vendit. Edhe pse në demokraci kemi liri dhe të drejta të barabarta, duhet të kemi edhe tolerancë ndaj njëri-tjetrit. Duhet të kemi parasysh që nuk duhet ta cenojmë lirinë e tjetrit, por dhe duhet të kemi respekt dhe bashkëpunim.




Fotografia e grupit



Në këtë fotografi mund të shihni Gentianën duke pyetur Muhamedin për zgjedhjet në demokraci



Muhamedi duke treguar se çka janë zgjedhjet dhe rëndësinë e këtij procesi në demokraci



Deputeti duke mbajtur fjalim para qytetarëve



Grupi duke bashkëpunuar

# KUVENDI, QEVERIA DHE GJYKATAT

DIART (15), GRESA (15), BESMIR (17), RINORA (15), ARIDON (15)



**Edhe pse pushteti ndahet në tri pjesë, kjo nuk do të thotë se këto pushtete nuk bashkëpunojnë. Ato kanë lidhshmëri me njëra-tjetrën sepse Kuvendi i miraton ligjet, Qeveria i zbaton ato dhe Gjykatat merren me personat që nuk iu përmbahen ligjeve**

Lexues të dashur, ne nxënësit e klasës e IX-4 nga shkolla „Emin Duraku“ e patëm rastin që të punojmë si gazetarë në projektin „Demos-ti“.

Fillimisht ne u ndamë në tri grupe, ku secili nxënës shprehu dëshirën e tij për rolin apo punën që dëshiron ta bëjë. Ne gjatë punës në grup të vogël, biseduam rreth demokracisë, mënyrës së ndarjes së pushtetit në Kosovë e shumë gjëra të tjera.

Ne në grup i diskutuam funksionet e Kuvendit të Kosovës. Ne gjithashtu i kemi ndarë punët tona brenda grupit, duke u bazuar në dëshirat tona. Unë, Rinora bashkë me Gresën kemi zgjedhur të shkruajmë këtë artikull për temën „Ndarja e Pushtetit“ duke e ndjerë

veten si gazetarë. Ndërsa shokët tanë Besmiri, Aridoni dhe Diarti patën dëshirë që të vizitojnë diçka rreth funksioneve që kryen Kuvendi.

Jemi duke u ndjerë shumë mirë që mësuam diçka të re sot dhe falë këtij projekti na është mundësuar që ta vizitojmë edhe Kuvendin.

Ne jemi duke hulumtuar për ngjarjet aktuale që janë duke ndodhur në vendin tonë, duke shpresuar se në Kosovë do të respektohen elementet demokratike çdo herë e më shumë.

Nga kjo që biseduam në grup kuptuam që pushteti i Kosovës është i ndarë në tri pjesë ashtu siç jemi ndarë edhe ne në tri grupe.


Pushteti ndahet në këtë mënyrë : Pushteti Legjislativ, Pushteti Ekzekutiv dhe Pushteti Gjyqësor.

Pushtetin Legjislativ e ka Kuvendi i Republikës së Kosovës, ku aty miratohen ligjet nga votat e 120 deputetëve. Pushteti Ekzekutiv i propozon ligjet dhe i ekzekuton ato, si dhe Pushteti Gjyqësor i cili merret me personat të cilët nuk e zbatojnë ligjin duke i gjykuar ata. Është interesante që ne si qytetarë e kemi të drejtën e votës për t'i zgjedhur deputetët dhe ata kanë përgjegjësi të na përfaqësojnë neve në mënyrën më të mirë. Deputetët e zgjedhin Kryeministrin, i cili ka për detyrë të jap llogari tek deputetët dhe në fund Kryeministri e zgjedh kabinetin qeveritar, pra ministrat ku secili prej tyre ka detyrat e veta. Pra, gjithçka është e lidhur në mënyrë zingjirore.

Ne duke e përfunduar këtë artikull duam t'i falenderojmë trajneret tona, duke lënë porosi që të gjithë nxënësit e shkollave ta vizitojnë këtë vend.



Gazetarët e Kuvendit të Kosovës



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
 REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
 REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY


i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**



Redaktohet nga  
 Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
 Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
 TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
 Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Emin Duraku“  
 E-mail: info@demos-ti.org Klasa: IX-4  
 Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë

